

SYLLABUS

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Menaxhmentit
Programi:	Menaxhimi i Biznesit dhe Ndërmarrësia
Titulli i lëndës:	Menaxhimi i Financave
Niveli:	Bachelor
Statusi i lëndës:	O
Viti i studimeve:	III
Semestri:	VI
Numri orëve në javë:	3
Vlera në kredi – ECTS:	4
Koha / lokacioni:	UShAF
Mësimdhënësi i lëndës:	
Detajet kontaktuese:	
Përshkrimi i lëndës	Lënda përfshinë materialin shkencor i cili do të përpunohet duke prezantuar aspektin teorik dhe praktik me punime dhe hulumtime për – Financat dhe menaxhimi i tyre, Organizimi i bizneseve në vende, Vlera në kohe e parasë, Burimet e financimit, Analiza financiare, Pasqyrat financiare në kompani, Mjedisi financiar i firmës, Investimet dhe biznesi, Buxhetimi i kapitalit, Kosto e kapitalit, Leva oportune dhe financiare, Objektivat dhe planifikimi financiar, Financat në kompani, Financimi i kapitalit punues, Dividenda dhe aksioni, Risku në biznes, Kontrolli i biznesit,
Qëllimet e lëndës	Të krijoj njohuri të studentet për financat, mënyrën e menaxhimit të financave në një kompani, duke identifikuar burimet e financimit, raportet financiare, vlerën në kohe të parasë, pastaj studentet do të njoftohen me aktivitetin financiar që zhvillohet në kompani, si janë të organizuara bizneset, si kryhet analiza financiare, përdorimi i levës oportune dhe financiare, risku në kompani, kontrolli i biznesit, duke marrë shembuj dhe duke zhvilluar detyra varësisht nga tema e ligjëratës.
Rezultatet e pritura të mësim-nxënies	Pas përfundimit të suksesshëm të modulit, studenti duhet të: 1. Përfitoj njohuri bazike për financat, planifikimin dhe menaxhimin e tyre ndërmarrje, (ECTS: 0.50), 2. Kuptoj rolin e Inteligjencës Artificiale në Menaxhimin e Financave dhe Investimeve si dhe të Listoi llojet e biznesit në vend, (ECTS: 0.50), 3. Identifikoj dhe të kuptoj një analize bazike të pasqyrave financiare në ndërmarrje, (ECTS: 1), 4. Dallon cilat janë llojet e burimeve financiare dhe raportet - treguesit financiar, (ECTS: 1), 5. Kuptoj aspektet bazike të riskut në kompani, të buxhetimit dhe kostot e kapitalit në biznes, (ECTS: 0.50), 6. Të jete kompetent për të marrë pjesë në mjedis pune, në pune ekipore në qështje financiare dhe kontrolle pune në ndërmarrje, (ECTS: 0.50),

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrimet teorike/detyra	1	15	15
Punë praktike	3	1	2
Kontaktet me mësimdhënësit – konsultimet	1	5	5
Përgatitja për detyra projekte	1	5	5
Projekt kursi - Test (planifikim + zbatim)	1	2	2
Detyra të shtëpisë	1	5	5
Koha e studimit vetanëk të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)			30
Përgatitja përfundimtare në provim	1	2	2
Koha e kaluar në vlerësim (teste, provim final)	1	2	2
Projektet, prezantimet etj	1	2	2
Totali			100
Metodologjia e mësimdhënies dhe mësim-nxënies	Ligjërata do të organizohet duke pas studentin në qendër, do të dëgjohet opinioni i studenteve për literaturën që do të përdoret, për mënyrën e organizimit të ligjërës dhe cila do të jetë interaktive lidhur me temat e ligjërës dhe zgjedhjen e detyrave, orientimi në shtjellimin e materialit do të diskutohen në grup, vizita dhe diskutime praktike për detyrat, prezantimi i studenteve për Raste studimi, Punime seminari apo Hulumtim praktik nga sfera e financave në kompani.		
Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë	<u>Metoda e vlerësimit</u> – mbështetet në tri aktivitete – në bazë të cilave do të ndërtohet nota përfundimtare: ➤ Aktivitet dhe Angazhim në mësim.....max 20 pikë (%), ➤ Prezantimi i projektit/punim seminari.....max 10 pikë (%), ➤ Provimi final (ose nga dy teste).....max 70 pikë (%), <u>Kriteret e kalueshmërisë:</u> 1. Aktiviteti dhe Angazhimi në mësim – vlerësohet me 20 pikë (%) nga 100 pikët (%) e mundshme: • Aktiviteti në mësim (10 pikë (%)) - nënkupton që studenti të jetë aktive dhe i përfshirë në diskutime interaktive profesor-studentë, studentë-studentë, duke hapur tema të reja që janë të ndërlidhura me lëndën, duke dhënë ide, opinione, mendime kritike me qëllim të nxitjes së debatit gjatë ligjërës. • Angazhimi (10 pikë (%)) - nënkupton që studenti të kryejë dhe prezantojë detyrat që caktohen në fund të secilës ligjërë dhe pastaj diskutohen në fillim të ligjërës vijuese. Qëllimi: Nxitja e mendimit kritik dhe zgjidhja kreative e situatave reale ndërlidhur me problemet e parashtruara - të ndërlidhura me mësim-nxënien në modulin e lëndës. 2. Hartimi dhe prezantimi i një projekti/punimi seminari - vlerësohet me 10 pikë nga 100 pikët (%) e mundshme,		

Brenda semestrit studenti (mund të jetë një grup i studenteve – jo me shume se 3 studentë) duhet të përgatit një projekt/punim seminar (Word dhe në PowerPoint), i njëjti punim duhet të prezantohet gjatë orëve të caktuara për prezantim. Prezantimi do të zgjasë më së shumti 15 minuta.

Tema e punimit mund të propozohet nga profesori dhe nga studenti – tema e propozuar nga studenti duhet të miratohet nga profesori, dhe e njëjta duhet të jetë në korrelacion të plot me lëndën.

Punimi prezantohet para grupit dhe vlerësohet në bazë të cilësisë së përmbajtjes, analizës, kreativitetit dhe aftësisë për ta prezantuar qartë.

Kriteret e vlerësimit të projektit/punimit seminar	
Komponenti	Pikët (%)
Struktura dhe Qëllimi i punimit	3
Përmbajtja/shtjellimi i punimit	4
Përfundimet e nxjerra dhe prezantimi i punimit	3
Gjithsej:	10

Qëllimi: zhvillimi i aftësive kërkimore, analitike dhe shkencore, përmes trajtimit të një teme të caktuar në mënyrë të pavarur dhe akademike - të ndërlidhura me mësim-nxënien në modulin e lëndës.

3. Testi i provimit final, vlerësohet me 70 pikë (%) nga 100 pikët (%) e mundshme,

Brenda semestrit parashihet të mbahen dy Teste (2 x 35 pikë (%)) për studentët e angazhuar aktiv me pjesëmarrje në ligjërata, testi i parë në javën e 7 ose të 8 dhe testi i dytë në fund të ligjëratave, studenti e kalon testin nëse ka min. 18 pikë (%), pasi që studenti vlerësohet se ka kaluar testin e parë, atëherë studenti mund t'i nënshtrohet testit të dytë, studenti ka të drejtë të nënshtrohet drejtpërdrejt provimit final - me gojë ose me shkrim. Studenti do t'i nënshtrohet testit të provimit final, pas përfundimit të ligjëratave të lëndës dhe në afatet e provimeve të përcaktuara nga senati i Universitetit.

Testi i provimit (formulari me pyetje) duhet të plotësohet në mënyrë individuale nga studenti dhe i njëjti vlerësohet sipas kriterëve dhe përmban:

- ♦ pyetje objektive me zgjedhje të shumëfishta alternative, të njëjtat do të shfrytëzohen për të vlerësuar aftësitë e studentit për të ri- kujtuar dhe njohur konceptet dhe materialin e lëndës.....**30 pikë (%)**
- ♦ pyetje subjektive të llojit tema për shpjegim/përgjigje me shkrim/detyra - për të cilat vet studenti duhet të jete në gjendje të jep përgjigje ndërlidhur me materialin e lëndës së ligjëruar, të njëjtat përgjigje do të shfrytëzohen për të vlerësuar të kuptuarit dhe aftësitë e studentit për të zbatuar njohuritë e fituara në analizë, sintezë/vlerësim të problemit.....**40 pikë (%)**

Qëllimi i testit: të vlerësojë përvetësimin e rezultateve të mësim-nxënies dhe aftësinë për t'i zbatuar ato në situata praktike.

Studenti e kalon provimin nëse grumbullon 50 pikë (%) nga të gjitha aktivitetet e parapara me metodën e vlerësimit,

	Notat në UShAF: <table><tr><th>Nota</th><th>ECTS/Nota</th><th>Përqindja (%)</th><th>Përkufizimi</th></tr><tr><td>10</td><td>A</td><td>90 - 100</td><td>Shkëlqyeshëm</td></tr><tr><td>9</td><td>B</td><td>80 - 89</td><td>Shkëlqyeshëm</td></tr><tr><td>8</td><td>C</td><td>70 - 79</td><td>Shumë mirë</td></tr><tr><td>7</td><td>D</td><td>60 - 69</td><td>Mirë</td></tr><tr><td>6</td><td>E</td><td>50 - 59</td><td>Mjaftueshëm</td></tr><tr><td>5</td><td>FX/F</td><td>0 - 49</td><td>Pamjaftueshëm</td></tr></table>	Nota	ECTS/Nota	Përqindja (%)	Përkufizimi	10	A	90 - 100	Shkëlqyeshëm	9	B	80 - 89	Shkëlqyeshëm	8	C	70 - 79	Shumë mirë	7	D	60 - 69	Mirë	6	E	50 - 59	Mjaftueshëm	5	FX/F	0 - 49	Pamjaftueshëm
Nota	ECTS/Nota	Përqindja (%)	Përkufizimi																										
10	A	90 - 100	Shkëlqyeshëm																										
9	B	80 - 89	Shkëlqyeshëm																										
8	C	70 - 79	Shumë mirë																										
7	D	60 - 69	Mirë																										
6	E	50 - 59	Mjaftueshëm																										
5	FX/F	0 - 49	Pamjaftueshëm																										
Mjetet e konkretizimit – TI	Përdorimi i Smart-tabelës, Interneti, wireless, kompjuteri, projektori, PowerPoint, Përdorimi i platformave dhe mjeteve “on-line” për të mbështetur komunikimin dhe bashkëpunimin në ekip, etj.																												
Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit	70% - Teori, 30% - Ushtrime praktike, Ky raport ka për qëllim të analizojë lidhjen ndërmjet njohurive teorike të përfituara gjatë ligjëratave të parapara në modulin e lëndës dhe realizimit të ushtrimeve praktike (vizita praktike, ushtrime me studente, kuize studentore në klase, etj) Nga gjithsej 100 orë të parapara për lëndën, ndarja është bërë sipas raportit 70% në fokus në teori dhe 30% në praktikë. • 70 orë janë të dedikuara për ligjërata teorike, përfshirë përvetësimin e koncepteve bazë, metodologjive dhe standardeve të parapara në modulin e lëndës. • 30 orë janë të fokusuar në ushtrime praktike, vizita pune, analiza rastesh konkrete, punë në grup dhe zhvillim projektsh simulimi. Ndarja e 4 ECTS: ❖ 3 ECTS i dedikohen pjesës teorike ❖ 1 ECTS i dedikohen pjesës praktike. Kjo ndarje reflekton balancën ndërmjet përvetësimit të koncepteve bazë dhe zbatimit të tyre përmes aktiviteteve praktike.																												
Literatura																													
Literatura bazë	1. Skënder Ahmeti – “Analiza e pasqyrave Financiare”, Prishtinë 2020, 2. Ismail Mehmeti - “Menaxhimi i Financave”, Ferizaj 2025, (Ligjëratë e autorizuar),																												
Literatura shtesë	1. Mustaf Pllana – “Kalkulime, Analiza Financiare dhe Planifikim”, Prishtinë 2020, 2. Rexhepi, G. - “Zhvillimi i teknologjisë dhe ndikimi i saj në menaxhimin financiar: Rasti i përdorimit të inteligjencës artificiale në Shqipëri”. 2022 Tirana: Universiteti i Tiranës. 3. Brigham, E. F., & Houston, F. Fundamentals of financial management (16th ed. - 2022). 4. Isa Mustafa – “Menaxhmenti Financiar”, Prishtinë 2008,																												
<u>Informacion shtesë</u> – Punimi Shkencor nga profesori i lëndës:	* Punimi Shkencor nga autorët: Deda, G., Bislimi, F., Krasniq, S., Tërstena, A. & Mehmeti, I. Titull – “Managerial Competences and Strategic goal Achivment: A Survey-Based Study of SME's”, i botuar në Revisten shkencore “Corporate & Business Strategy Review / Volume 6, Issue 2, 2025” ISSN Online: 2708-4965, ISSN Print: 2708-9924.																												

	Tema nga punimi: “Determinantes, to measure strategic goal achievement” Link to the work: file:///C:/Users/DELL/OneDrive%20-%20University%20of%20Applied%20Sciences%20in%20Ferizaj/1-SHENIME-jan%20bart%20ne%20OnDrive%20me%20110225/7-Punimet-Konferencat%20Shkencore/24-PSh-Gazi,Fisi,Arbeni,Sokoli%20dhe%20Ismaili/SP-F-Corporate%20&%20Business%20Strategy%20Review.pdf
Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë	Prezantimi – njoftimi i studenteve me syllabusin e lëndës, Financat dhe menaxhimi i tyre, Është ligjëratë hyrëse, studentet njoftohen me plan-programin e lëndës, zgjedhin grupet punuese për hartim të projekt/punimit, fillohet me ligjëratë gjithëpërfshirëse për financat, definimi, menaxhimi i financave. Rezultati i pritur nr. 1.
Java e dytë	Inteligjenca Artificiale dhe Menaxhimi i Financave, Llojet e bizneseve, Studentet njoftohen me rolin që ka IA në menaxhimin e financave, si ka ndikuar aplikimi i IA në rritjen e efikasitetit, në shpejtësinë e vendimmarrjes, në mënyrën e shpërndarjes së financave në kompani dhe në shumë aktivitete tjera financiare në biznes. Studentet do të njoftohen edhe me llojet e bizneseve që funksionojnë në vend. Rezultati i pritur nr. 2.
Java e tretë	Organizimi i financave në kompani, Analiza Financiare, Në këtë ligjëratë do të ketë ushtrime-përsëritje, me studente do të diskutohet për mënyrën e organizimit të financave në kompani, për detyrat e menaxherit financiar dhe atij të kontabilitetit, si duhet të jenë informatat financiare, studentet do të njoftohen me treguesit financiar në organizate, si mund të jete gjendja financiare në organizate në periudha të ndryshme të aktivitetit të sajë afarist, diskutim grupor me studentë. Rezultati i pritur nr. 1.
Java e katërt	Vlera në kohe e parësë, Interesi si element i vlerës në kohe të parësë, Në këtë ligjëratë do të ketë ushtrime, studentet do të njoftohen me konceptin e vlerës në kohe të parësë, pse është me rëndësi për menaxherin financiar të dije vlerën e parësë në kohën e caktuar dhe si ndikon ajo në afarizmin e kompanisë, fokusi do të jete në detyra dhe zgjedhjen e tyre për vlerën e tashme dhe të ardhshme të parësë, studentet do të njoftohen edhe për interesin si një element i rëndësishëm që duhet të përcillet nga financieret në kompani, do të ketë diskutime interaktive me studentë. Rezultati i pritur nr. 1.
Java e pestë	Rrjedha e parësë kesh, Pasqyrat financiare,

	Studentet do te njoftohen me rendësin e rrjedhës se parasë kesh për kompaninë, çka paraqet “Kesh Fllow”, do te diskutohet për aktivitet kryesore qe zhvillohen te rrjedha e parasë kesh, po ashtu studentet do te njoftohen me pasqyrat financiare qe janë ne një kompani, cilat janë llojet e pasqyrave financiare te një kompanie, do te ketë diskutime me studente dhe zgjidhje te detyrave, studentët e organizuar ne grupe do te prezantojnë punimet dhe detyrat e tyre. Rezultati i pritur nr. 3.
Java e gjashtë	Raportet financiare ne kompani, Koeficientet e Raporteve financiare, Ne këtë ligjëratë studentet do te njoftohen me rendësin e raporteve financiare për afarizmin e kompanisë, si ndikojnë ne identifikimin e gjendjes financiare koeficientet qe përdorën ne këto raporte, cilët janë koeficientet për secilin raport financiare, duke e ilustruar me detyra praktike dhe duke i angazhuar studentet ne diskutim dhe zgjedhje te detyrave, do te ketë prezantim te punimeve nga studentët. Rezultati i pritur nr. 4.
Java e shtatë	Burimet financiare, Leva Operative dhe Financiare, Ne këtë ligjëratë do te ketë ushtrime numerike – përsëritje, studentët do te njoftohen me burimet e mundshëm financiare për një kompani ne tregun e kapitalit financiare, do te diskutohet për levën operative dhe atë financiare si ndikon leva operative për financimin e biznesit fillestar dhe si ndikon dhe si përdoret leva financiare ne një biznes, do te ketë shembuj dhe detyra për te demonstruar mënyrën e përlllogaritjes, do te ketë prezantim te punimeve nga studentët. Rezultati i pritur nr. 3. Parashihet te organizohet Testi i parë,
Java e tetë	Inteligjenca Artificiale dhe Investimi i kompanisë, Faktorët përcaktues për të matur arritjen e qëllimit strategjik, Studentet do te njoftohen me përpirësit qe i ofron IA ne analizën, përpunimin dhe aplikimin e te dhënave ne planifikimet për investime, për analizën dhe identifikimin e portofolios se kompanisë si dhe faktorët tjerë qe ndikojnë ne arritjen e qëllimeve strategjike te biznesit për investim dhe depërtim ne tragë. Rezultati i pritur nr. 2 dhe 5.
Java e nëntë	Buxhetimi dhe Kosto i kapitalit, Ne këtë ligjëratë do te ketë ushtrime numerike, studentet do te njoftohen me rolin dhe rendësin e buxhetimit te kapitalit për organizatën, për vendimmarrjen për buxhetim te kapitalit, kriteret qe merren parasysh me rastin e buxhetimit, Kosto e kapitalit – kuptimi, cilat mund te jene burimet e financimit për një kapital financiar qe ka nevojë kompania, ilustrimi i kapitalit investiv dhe koston se atij kapitale duke zgjedh detyra – synim angazhimi i studenteve ne punimin e detyrave, do te ketë prezantime te punimeve nga studentet. Rezultati i pritur nr. 5 dhe 6.
Java e dhjetë	Mjedisi financiar, Tema nga Punimi Shkencore, Ne këtë ligjëratë do te ketë ushtrime numerike, studentët do te njoftohen me rendësin e mjedisit financiare aty ku ato zhvillojnë aktivitetin afarist, si

	ndikon mjedisi financiar ne sigurimin e kapitalit te nevojshëm për kompaninë, do te prezantohet tema nga punimi shkencor, diskutim grupor dhe prezantim nga studentet. Rezultati i pritur nr. 6.
Java e njëmbëdhjetë	Objektivat dhe planifikimi financiar, Ne këtë ligjëratë do te ketë ushtrime numerike, studentët do te njoftohen me objektivat financiare te kompanisë, sa është me rendis qe te arrihen këto objektiva – posaçërisht me maksimizimin e vlerës se kompanisë, diskutim grupor dhe prezantime nga studentet. Rezultati i pritur nr. 1.
Java e dymbëdhjetë	Financat ne kompani - fushat, Ne këtë ligjëratë do te ketë ushtrime- përsëritje, studentet do te njoftohen fushat qe i synojnë kompanitë për ti financuar me qellim te rritjes dhe maksimizimit te fitimit dhe te depërtimit ne një treg sa me te gjere, varësisht nga mundësia – planifikohet vizite pune ne një institucion apo organizate biznesore, studentët do te angazhohen për pune grupore ne zgjedhje te detyrave dhe do te prezantojnë punimet e tyre. Rezultati i pritur nr. 2.
Java e trembëdhjetë	Financimi i kapitalit punues, Ne këtë ligjëratë studentet do te njoftohen për financimin e kapitalit punues dhe për rendësin e përzgjedhjes se drejte te financimit për makineri te re, lëndë te parë, pajisje, etj, do te ketë interaktivitet studentore, diskutim për detyra dhe studentët do te prezantojnë punimet e tyre. Rezultati i pritur nr. 6.
Java e katërbëdhjetë	Risku ne biznes, Ne këtë ligjëratë do te ketë ushtrime numerike, përsëritje, diskutime me studentë – studentët do te njoftohen për kuptimin e riskut dhe si duhet te trajtohet ai nga një kompani, burimet e riskut ne kompani, cili mund te jete relacioni ne mes riskut dhe kthimit nga një investim i mundshëm i një kompanie, do te diskutohet për klasifikimin e riskut duke i angazhuar studentet ne diskutime interaktive për temën, do te ketë prezantim te punimeve nga studentet. Rezultati i pritur nr. 5,
Java e pesëmbëdhjetë	Kontrolli ne biznes, Ne këtë ligjëratë do te ketë ushtrime – përsëritje, studentët do te njoftohen me kontrollin qe duhet te kryhet ne kompani me qellim te verifikimit te gjendjes se kompanisë ne një periudhe te caktuar kohore, studentët do te prezantojnë punimet dhe do te ketë diskutime interaktive. Rezultati i pritur nr. 6, Parashihet te organizohet Testi i dytë,
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes	
Studenti është i obliguar t'i vijojë ligjëratat më rregull dhe të ketë sjellje korrekte nda j kolegëve dhe stafit të Universitetit, mbajtja e qetësisë dhe angazhimi aktiv në ligjëratat dhe ushtrime është e obligueshme. Gjatë orëve të ligjëratave dhe ushtrimeve NDALOHET ushqimi, pëshpërimat që pengon punën në klasë dhe përdorimi i telefonave mobil. Njëkohësisht, telefonat celularë duhet të fiken ose të vihen në heshtje dhe të mos përdoren gjatë kohës së ligjëratave apo ushtrimeve. Mungesa e integritetit akademik (ku përfshihet plagjiatura, kopjimi i punës së një personi tjetër, përdorimi i ndihmave të	

paautorizuara në provime, mashtrimi etj) nuk do të tolerohet. Nëse ka dyshime për vërtetësinë e punës së paraqitur, mësindhënësi ka të drejtë t'i kërkoj studentit të verifikojë punën e tij/saj. Kjo mund të bëhet përmes: përsëritjes së punës, testimit me shkrim ose me gojë, kuiz i papritur apo me çdo veprim tjetër që konsiderohet i nevojshëm nga ligjëruesi.